



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 423/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani Kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e parashtruar nga Synavere Rysha kandidate për deputete për Parlamentin e Republikës së Kosovës nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Kaçanik, paraqitur për shkak të mungesë së votave në FRK, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Synavere Rysha kandidate për deputete për Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së, dega në Kaçanik.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 27.06.2014, në ora 13.18 ka pranuar një ankesë nga Synavere Rysha kandidate për deputete për Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së, dega në Kaçanik, në të cilën ankesë pretendohet se në komunën e Kaçanikut nga 287 vota të saja janë dhënë vetëm 87 vota në rezultatin final të KQZ ku i mungojnë 200 vota. Po ashtu edhe në komunën e Vitisë në fshatin Mogillë i mungojnë votat e saja thuhet në pretendimet ankimore. Ajo pohoi se për shkak të kohës se shkurt nuk ka arritur të na siguroj asnjë provë.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante sepse nuk e posedon asnjë dëshmi për ti vërtetuar pretendimet ankimore, dhe nuk ka dhënë asnjë udhëzim dhe hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë të cilat nuk kanë qenë në posedim të saj lidhur me at se çka pretendon në ankesë, prandaj ankesa vlerësohet si e pabazuar duke u bazuar në Nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet”, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 423/2014 më datën 30.06.2014.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*